




REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/12022025/DI**

Datë: **12.02.2025**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektim në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Departamenti i Inspektimit nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Objekti	- Menaxhimi i punësimit dytësor në Stacionin Policor të Podujevës
Arsyet e inicimit	- Me kërkesë të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, me datë 22.01.2025, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar Departamentin e Inspektimit që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar praktikën e punësimit të punonjësve policor në detyra dytësore. Ditë më parë, IPK ka pranuar një ankesë, sipas së cilës janë duke u shkelur udhëzimet administrative në fushën e punësimit dytësor në Stacionin Policor - Podujevë. Është pretenduar të ketë praktika të padrejta në angazhimin e personelit në punë dytësore, favorizime, tejkalim të angazhimit në raport me kufizimet, etj. Sipas të njëjtit, praktikën e tilla janë në kundërshtim me rregullat e procedurat në fuqi, mund të sjellin pakënaqësi dhe rënie të motivit për punë në radhët e strukturës në fjalë. Inspektimi ad hoc ka ofruar një mundësi për t'u njohur me respektimin e rregullave dhe procedurave gjatë punësimit dytësor, respektimin e parimit për mundësi të barabarta, si dhe mos diskriminim.
Objektivat	- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të punësimit dytësor, si dhe parimeve për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.
Metodologjia	- Gjatë realizimit të punës inspektuese, është përdorë metodologjia si në vijim: (a) Është realizuar takim me drejtues dhe bartës të funksioneve si në vijim: - Komandantin e Stacionit Policor - Podujevë, - Udhëheqësin e Sektorit të Operativës, - Udhëheqësin e Sektorit të resurseve; (b) Janë kryer kontrole (këqyrje apo verifikime): - të angazhimit të personelit bazuar në marrëveshjet me palët; (c) Janë marrë dokumente, si: - Oraret mujore dhe ditore (Nëntor dhe Dhjetor 2024), - Vendimet për punësim dytësor, - Marrëveshjet me palët, ku kërkohet zbatimi i autorizimeve policore, - Raportet e angazhimit në punë dytësore (Korrik - Dhjetor 2024).
Subjekti	- Stacioni Policor - Podujevë
Afatet	- Inspektimi ka filluar më 27.01.2025 dhe ka përfunduar në po të njëjtën ditë.
Kriteri i vlerësimit	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 për Marrëdhënien e Punës.
Përgatitur nga	- Xhavit Fetahaj, inspektor
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Datë	- 12.02.2025




Gjetjet

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ka rregulluar punësimin dytësor, i cili nënkupton angazhimin e zyrtarëve policor jashtë punës së rregullt, sipas marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Policisë dhe organizatave apo institucioneve tjera ku kërkohet zbatimi i autorizimeve policore. Sipas nenit 40 të Udhëzimit, zbatimi i këtyre autorizimeve, përfshinë disa fusha, duke mos u kufizuar vetëm në: kontrollimin e komunikacionit dhe sigurinë e këmbësorëve, kontrollimin e masës, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës, zbatimin rutinor të ligjit për autoritetet publike. Për t'u lejuar angazhimi në punë dytësore, sipas nenit 42 të Udhëzimit, punonjësit e interesuar duhet të ushtrojnë kërkesë në formular përkatës, që më pas i nënshtrohet procedurës së aprovimit nga Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë. Stacioni Policor - Podujevë ka prezantuar 61 vendime, me të cilat është lejuar angazhimi i punonjësve në punë dytësore. Raportet pasqyrojnë se përgjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2024, janë angazhuar gjithsej 57 zyrtarë policor të të gjitha gradave. Katër (4) zyrtarë të tjerë nuk dëshmohet të jenë angazhuar në punë dytësore, meqë njëri ka qenë i liruar nga sforcimet fizike (PK-4800), njëri ka qenë i transferuar nga Stacioni (PK-11086), njëri nuk ka shprehur interesim për punë dytësore (PK - 1592), kurse i katërti është sistemuar së voni në kuadër të Stacionit (PK-11930). Edhe Komandanti i Stacionit ka qenë i angazhuar në punë dytësore dhe me gjithë faktin se për të njëjtin ka aprovim nga autoriteti vendimmarrës, menaxhmenti i lartë i Policisë duhet të rishikojë praktikën e tillë, nëse cenon autoritetin e tij para publikut.

Tabela 1 - Numri i orëve të llogaritura si punë dytësore (Korrik - Gusht 2024)

Indikatori	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Numri i orëve	560	660	856	928	868	1.740	5.612
Numri i zyrtarëve	29	35	40	48	41	47	240
Mesatarja e orëve	19	19	21	19	21	37	23

2. IPK është interesuar të njihet me praktikën e aplikuar në Stacion, të angazhimit të personelit të uniformuar në punë dytësore. Sipas drejtuesve të Stacionit, hartohet orari mujor i angazhimit në punë të rregullt, kurse mbi këtë bazë për çdo ditë hartohet edhe orari ditor, që mund të ndryshoj nga ai mujor për shkak të dinamikave dhe aktiviteteve të paparashikuara. Kjo situatë pamundëson krijim të një liste me renditje të personelit që mund të angazhohet në punë dytësore. Kjo lë të nënkuptohet se angazhimi në punë dytësore bazohet varësisht prej kërkesave të palëve nënshkruese të marrëveshjeve për shërbime policore dhe disponueshmërisë së personelit të lirë dhe të pa caktuar në orar të rregullt të punës. Për të hequr dilemat nëse mund të ketë favorizime në caktimin e zyrtarëve në punë dytësore, IPK ka verifikuar raportet për gjashtë (6) muajt e fundit të angazhimit të personelit në punë dytësore. Sipas të dhënave të disponueshme, derivon një mesatare prej rreth 22 orë në muaj për zyrtar, të përfshirë në punë dytësore. Duke marrë parasysh këtë mesatare, na pasqyrohet përfshirje e një numri zyrtarësh në punë dytësore, nën/mbi këtë mesatare, duke iu ofruar mundësi disa prej tyre që të përfitojnë më shumë krahasuar me zyrtarët tjerë (shih diagramin). Janë identifikuar shtatë (7) zyrtarë policor, dy (2) prej të cilëve me gradën Toger dhe Rreshter, që kanë realizuar punë dytësore mesatarisht mbi 32 orë në muaj. Ky Raport përmban edhe shtojcën në formë tabelore, ku pasqyrohet numri i orëve sipas muajve për secilin punonjës të angazhuar në punë dytësore. Shtojca përmban edhe të dhëna (me shkronja të kuqe) që pasqyrojnë numrin e orëve të realizuara nga punonjësit policor me grada.



3. Kontrolli i raporteve të angazhimit të personelit në punë dytësore ka shpërfaqur disa dukuri, të cilat janë të dëmshme për organizatën. Njëra dukuri që është prezent në së paku dy (2) raste lidhet me faktin se janë hasur situata kur punonjës të caktuar kanë realizuar punë dytësore dhe në përfundim të këtij angazhimi kanë vazhduar me orar të rregullt të punës, duke stërzgatur orarin e angazhimit ditor deri në 16 orë pandërprerë¹. Dukuria tjetër që është prezent në së paku pesë (5) raste, lidhet me faktin se janë hasur situata kur punonjësit kanë realizuar punë dytësore në dy faza pandërprerë deri në 16 orë pune². Këto dy dukuri ndikojnë në punën cilësore të personelit, cenojnë trajtimin e barabartë të punonjësve dhe nxisin pakënaqësi në punë, duke reflektuar edhe në rënie të motivit në punë për shkak të favorizimit të individëve. Përveç këtyre praktikave jo të duhura, IPK ka gjetur edhe tre (3) raste kur punonjës të caktuar janë angazhuar në punë dytësore, por brenda periudhës së angazhimit figurojnë edhe në orar të rregullt të punës me detyra të ndara³. Kjo përbën shkelje të rregullave mbi respektimin e orarit të punës me qëllim të përfitimit material.

4. Sa i përket kufizimeve të punës dytësore, Udhëzimi në nenin 41, pika 1 përcakton që të “punësuarit në Polici nuk mund të angazhohen në punë dytësore derisa nuk e kanë përfunduar me sukses periudhën e punës provuese”. Stacioni me gjithë faktin se përgjatë periudhës që mbulon ky inspektim, ka pasur numër të caktuar të zyrtarëve policor në fazën e trajnimit fushor (periudhë provuese), asnjërin prej tyre nuk e ka angazhuar në punë dytësore. Përveç këtij kufizimi, Udhëzimi në nenin 41, pika 3 përcakton edhe disa kufizime shtesë, sipas të cilave, “të punësuarit në Polici nuk mund të angazhohen në detyrë dytësore kur gjenden nën masën e suspendimit dhe kur ka rekomandim nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore për lirim nga sforcimet fizike”. Edhe nga këto kategori, IPK nuk ka hasur zyrtarë të jenë angazhuar në punë dytësore.

5. Udhëzimi në nenin 42, paragrafi 3 përcakton që “i punësuar mund të angazhohet në punë dytësore apo punë jashtë detyrës zyrtare maksimum 24 orë brenda javës, ose 96 orë brenda muajit”. Nga verifikimi i regjistrave të angazhimit të personelit në punë dytësore, janë hasur pesë (5) raste kur zyrtarët brenda javës kanë tejkalu limitin prej 24 orë të angazhimit në punë dytësore (nga një herë numrin e orëve e kanë tejkaluar zyrtarët me numra identifikues 11273, 11208, 809, kurse dy herë e ka tejkaluar zyrtari me numër identifikues 8316). Tejkalim të numrit të orëve përtej limitit 96 orë në muaj nuk është hasur.

6. Në vështrim të marrëveshjeve të Policisë së Kosovës me subjektet, Stacioni Policor - Podujevë gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2024 ka ofruar shërbime përmes punësimit dytësor në zbatim të nëntë (9) prej tyre. Kontrolli i raporteve të punësimit dytësor pasqyron se shërbimet policore janë ofruar konform kushteve (numrit të angazhuarve dhe periudhave të angazhimit) dhe brenda afateve kohore të marrëveshjeve të arritura. Marrëveshjet që kanë qenë në fuqi gjatë kësaj periudhe janë si vijon:

¹ Polici ID-11211 më 02.12.2024 figuron se ka kryer punë dytësore nga ora 08.00-16.00, kurse në punë të rregullt është angazhuar në orarin 16.00-24.00. Polici (PK-11208) më 24.12.2024 figuron se ka kryer punë dytësore nga ora 00.00-08.00, kurse në punë të rregullt është angazhuar në orarin 08.00-16.00.

² Toger ID-867 më 04.11.2024 është angazhuar fillimisht në punë dytësore nga ora 07.00-15.00 dhe ka vazhduar përsëri në punë dytësore nga 15.00-23.00. Polici i lartë ID-8316 më 26.11.2024 është angazhuar fillimisht në punë dytësore nga 07.00-15.00 dhe ka vazhduar përsëri në punë dytësore nga 15.00-23.00. Polici i lartë PK-8833 më 11.08.2024 është angazhuar fillimisht në punë dytësore nga 07.00-15.00 dhe ka vazhduar në punë dytësore nga 15.00-23.00. Polici i lartë PK-8854 më 11.09.2024 është angazhuar fillimisht në punë dytësore nga 07.00-15.00 dhe ka vazhduar në punë dytësore nga 15.00-23.00. Rreshter ID-6520 më 15.10.2024 është angazhuar fillimisht në punë dytësore nga 07.00-15.00 dhe ka vazhduar në punë dytësore nga 15.00-23.00.

³ Polici PK-11208 më 20.12.2024 është angazhuar në punë dytësore nga ora 08.00-16.00, kurse figuron në orar të rregullt të punës nga ora 08.00-16.00. I njëjti edhe më 18.12.2024 është angazhuar në punë dytësore nga ora 08.00-16.00, kurse figuron në orar të rregullt të punës nga ora 08.00-16.00. Rreshteri PK-4913 më 20.12.2024 është angazhuar në punë dytësore nga ora 11.30-15.30, kurse figuron në orar të rregullt nga ora 08.00-16.00.

	Palët në marrëveshje	Datë	Kohëzgjatja
	KEDS - Policia e Kosovës	04.07.2024	08.07.2024 - 08.07.2025
	Komuna e Podujevës - Policia e Kosovës	28.06.2024	01.07.2024 - 30.06.2025
	Komuna e Podujevës - Policia e Kosovës ⁴	04.09.2024	04.09.2024 - 30.06.2025
	KRU Prishtina - Policia e Kosovës	09.01.2024	01.01.2024 - 31.12.2024
	KF Llapi Podujevë - Policia e Kosovës	16.02.2024	15.02.2024 - 31.12.2024
	KF Podujeva - Policia e Kosovës	01.03.2024	01.03.2024 - 31.12.2024
	KH Llapi Podujevë - Policia e Kosovës	12.09.2024	12.09.2024 - 31.12.2024
	KFF Llapi Podujevë - Policia e Kosovës	03.05.2024	03.05.2024 - 31.12.2024
	KF BB Llapi Podujevë - Policia e Kosovës	02.04.2024	02.04.2024 - 31.12.2024
Përfundim	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Punonjësit policor që kanë ofruar shërbime policore në bazë të marrëveshjeve me organizata/institucione, kanë përmbushur kriterin për aprovimin e punës dytësore nga Divizioni i Personelit dhe Administratës. 2. Raportet e ofrimit të shërbimeve për palët në kuadër të marrëveshjeve pasqyrojnë dallime thelbësore të përfshirjes së personelit, duke ofruar mundësi jo të barabarta të përfitimit nga puna dytësore. 3. Inspektimi vë në pah disa praktika të gabuara të caktimit të personelit dhe shkelje të rregullave në respektimin e orareve të rregullta gjatë ushtrimit të punës dytësore, duke krijuar pakënaqësi dhe rënie të motivit për punë për shkak të favorizimeve. 4. Stacioni ka respektuar rregullat mbi kufizimet në përfshirjen e personelit në punë dytësore, që nënkupton se në angazhime të kësaj natyre nuk janë përfshirë policët e rinj në periudhë provuese dhe të liruarit nga sforcimet fizike. 5. Janë gjetur disa raste që zyrtarë të caktuar në punë dytësore kanë tejkuluar numrin e orëve të lejuara brenda javës (mbi 24 orë), derisa numri i orëve të lejuara brenda muajit nuk është tejkuluar. 6. Kushtet e parapara me marrëveshjet e arritura ndërmjet palëve janë respektuar nga ana e Stacionit kur kihet parasysh numri i të angazhuarve, periudha e angazhimit të tyre dhe afatet kohore (periudha e mbulimit). 		

⁴ Kjo është Aneks Kontratë për të ofruar shërbimet për Qendrën për Punë Sociale - Podujevë.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor të Podujevës, që të ushtrojë kontroll të duhur mbi drejtuesit që mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjeve me organizatat dhe institucionet, në respektimin e parimit për trajtim të barabartë gjatë caktimit të personelit të interesuar në punë dytësore, drejt eliminimit të favorizimeve të mundshme.	-I-	Drejtori Rajonal i DRP-Prishtinë cakton Shefin e Operativës Rajonale i cili do të mbikëqyrë angazhimin e Komandantit të Stacionit Policor Podujevë lidhje me menaxhimin dhe kontrollin e duhur për respektimin e parimit të trajtimit të barabartë të zyrtarëve gjatë caktimit të tyre në punë dytësore duke pasur parasysh implementimin në tërësi të rekomandimit të dhënë nga IPK. Përpilim i planifikimeve mujore nga administrata për punë dytësore në koordinim me sektorin operativ në raste kur ka në zbatim plane operative, duke pas për bazë trajtimin e barabartë të zyrtarëve.	Në vazhdimësi
2.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor të Podujevës, që të rishikojë disa nga praktikat e aplikuara të caktimit të personelit në punë dytësore, për t'u siguruar se krahas angazhimeve të tilla, ofrohet punë cilësore edhe në aktivitetet e stacionit.	-I-	Drejtori Rajonal i DRP-Prishtinë cakton Shefin e Operativës Rajonale i cili do të mbikëqyrë angazhimin e Komandantit të Stacionit Policor Podujevë i cili do të menaxhoj dhe mbikëqyrë që një praktikë e tillë e deritanishme të mos ndodhë dhe të përfilllet në përpikëri Rekomandimi nga IPK. Përpilim i planifikimit mujor nga administrata për punë dytësore në koordinim me sektorin operativ në raste kur ka në zbatim plane operative duke marrë për bazë Rekomandimin nga IPK.	Në vazhdimësi
3.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor të Podujevës, që të ushtrojë kontroll mbi angazhimet e personelit në punë dytësore, drejt eliminimit të mundësive të përfitimit të jashtëligjshëm të tyre, si rezultat i mosrespektimit të orarit të rregullt të punës në Stacion.	-I-	Drejtori Rajonal i DRP-Prishtinë cakton Shefin e Operativës Rajonale i cili do të mbikëqyrë angazhimin e Komandantit të Stacionit Policor Podujevë që të shtoj mbikëqyrjen dhe kontrollin lidhur me angazhimet e personelit në punë dytësore duke pas parasysh eliminimin e mundësive të përfitimit të jashtëligjshëm siç parashihet në rekomandimin e IPK-së.	Në vazhdimësi
4.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor të Podujevës, që të ushtrojë kontroll mbi respektimin e rregullave të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket orëve të lejuara brenda javës lidhur me angazhimin në punë dytësore.	-I-	Drejtori Rajonal i DRP-Prishtinë cakton Shefin e Operativës Rajonale i cili do të mbikëqyrë angazhimin e Komandantit të Stacionit Policor Podujevë i cili do të shtoj kontrollet kurse për një koordinim më të mirë të punës primare dhe asaj dytësore do të angazhoj një rreshter edhe nga zyra e operativës ku në bashkëpunim me administratën do të koordinojnë angazhimet e personelit për punë dytësore në mënyrë të plotësimi të rekomandimit nga IPK. Planifikim i përditësimeve rreth planeve dhe orareve mes të administratës dhe operativës.	Në vazhdimësi

Shtojca 1 - Lista e zyrtarëve të angazhuar në punë dytësore (Korrik - Dhjetor 2024)									
ID	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	Muaj	Orë mesatare
PK-10443	8	16	8	0	20	56	108	5	22
PK-11768	0	0	4	28	16	40	88	4	22
PK-08400	0	0	0	28	24	48	100	3	33
PK-08316	32	24	52	40	52	72	272	6	45
PK-04913	0	8	8	28	16	36	96	5	19
PK-06499	0	12	8	12	32	32	96	5	19
PK-05111	0	0	0	0	0	24	24	1	24
PK-10424	8	8	12	20	16	28	92	6	15
PK-03987	0	0	0	0	0	24	24	1	24
PK-06520	8	32	32	32	16	40	160	6	27
PK-00867	32	40	40	52	56	40	260	6	43
PK-06044	0	0	0	0	0	24	24	1	24
PK-03152	40	8	0	0	0	36	84	3	28
PK-11770	0	0	4	8	16	48	76	4	19
PK-08019	24	40	72	28	48	40	252	6	42
PK-08286	24	32	32	24	0	0	112	4	28
PK-10553	0	8	24	20	0	40	92	4	23
PK-01581	0	0	0	0	0	16	16	1	16
PK-11252	16	12	24	0	0	24	76	4	19
PK-11756	0	0	0	0	8	40	48	2	24
PK-10341	0	8	8	8	8	40	72	5	14
PK-11211	0	4	24	24	12	32	96	5	19
PK-03302	8	4	12	8	0	0	32	4	8
PK-08833	8	24	20	20	16	56	144	6	24
PK-11892	0	0	0	24	28	52	104	3	35
PK-11712	0	0	0	20	16	32	68	3	23
PK-03326	0	16	16	20	24	56	132	5	26
PK-11273	24	12	28	28	0	40	132	5	26
PK-10182	32	0	0	4	12	44	92	4	24
PK-11213	32	16	24	12	16	16	116	6	19
PK-11177	8	20	8	16	12	56	120	6	20
PK-04510	0	16	12	20	8	52	108	5	22
PK-11222	24	0	36	28	12	36	136	5	27
PK-08123	48	52	0	16	16	36	168	5	34
PK-10676	8	12	4	12	8	16	60	6	10
PK-08854	24	40	56	8	8	24	160	6	27
PK-11861	0	0	0	16	32	32	80	3	27
PK-11183	24	20	36	36	36	32	184	6	31
PK-11174	0	24	12	16	8	24	84	5	17
PK-11206	0	8	12	4	0	0	24	3	8
PK-00903	0	8	0	0	0	16	24	2	12
PK-11078	16	0	16	12	16	16	76	5	15
PK-11208	8	12	16	24	36	48	144	6	24
PK-01309	16	0	20	12	8	60	116	5	23
PK-04548	0	8	12	8	8	32	68	5	14
PK-00552	8	8	8	8	8	24	64	6	11
PK-11033	32	28	28	36	60	40	224	6	37
PK-11672	0	0	4	20	0	16	40	3	13
PK-07853	16	16	12	16	32	48	140	6	23
PK-07488	16	28	24	12	28	56	164	6	27
PK-00360	16	36	28	12	0	0	92	4	23
PK-11956	0	0	32	36	28	0	96	3	32
PK-11946	0	0	28	36	32	0	96	3	32
PK-11243	0	0	0	12	0	0	12	1	12
PK-11115	0	0	0	8	0	0	8	1	8
PK-11893	0	0	0	12	16	0	28	2	14
PK-11944	0	0	0	4	4	0	8	2	4
Gjithsej	560	660	856	928	868	1.740	5.612	4	22